

PARASHITRESE

Mbi hartimin e grafikut te punimeve

per Objektin :

“Sistemim, asfaltim, ndërtimi i korsisë së bicikletave dhe ndricim i rrugës hyrëse të qytetit, Loti 1 segmenti Elbasan - Peqin dhe unazës së qytetit”

PEQIN

Per hartimin e grafikut te punimeve, per projektin u studiuan volumet , u perllogariten oret e punes te nevojshme per kryerjen cdo zeri pune , u perzgjodh skema e organizimi ne raport me frontet dhe nderthurjen e proceseve te punes. Kohezgjatja e ndertimit u llogarit per te qene me e pershtatshmia e mundshme. Eshte parshikaur perqendrim i specialisteve, pa krijuar konfuzion. Kjo kerkon vleresim serios, kerkon drejtues punimesh te afte minimum inxhinier ndertimi te ndihmuar nga tekniku topograf.

Grafiku ka si njesi kohore, 2 javeshin , sepse ka kohe zgjatje relativisht te gjate. Periudha 2 javore eshte parashikuar me 12 dite pune dhe dita me 8 ore.

“Rikualifikimi i rruges hyrse per ne Peqin nga Elbasani”, parashikohet te perfundoje per 180 dite ose per 6 muaj. Kohe zgjatja e ndertimit ne grafik, eshte per punimet me nje turn. Kontraktori eshte ne te drejten e tij te paraqes grafikun e vete per kohezgjatjen e punimeve; kjo do te bashkerendohet me lidhjen e kontrates.

Ne grafik per fillimin e punimeve, nuk ka ndonje date te caktuar, ajo caktohet me lidhjen e kontrates. Ne kontraten qe do te lidhet ndermjet punedhenesit dhe firmes do te caktohet data e fillimit te punimeve dhe ajo e perfundimit te tyre. Ne kete moment mund te bihet dakord per te levizuur, ne te dy drejetime, kohezgjatjen e punimeve te parshikuar ne kete grafik.

Organizimi e punimeve ne kete grafik, kerkon qe :

.. punimet ne objekt te drejtohen nga nje inxhinier ndertimi me pervoje i mbeshtetur dhe me teknik topograf.

.. objekti do te funksionoje si sektor me magazina, zyra, mjete transporti dhe makineri e pajisje te nevojshme per pune normale.

.. personeli inxhiniero-teknik, para fillimit te punimeve duhet te zbertheje deri ne detaje organizimin e punes; si garanci per te realizuar objektit sipas projektit, ne kohe dhe me cilesine e kerkuar.

.. sektori do te kete lidhje telefonike me zyrat qendrore te firmes, me celular, c'ka do te jape mundesi komunikimi te shpejte dhe nderhyrje te menjehershme per zgjidhjen e emergjencav dhe problemeve te ndryshme.

Per ta bere grafikun me te qarte dhe me veprues nuk e kemi ndertuar sipas zerave te preventivit, por me grupim zerash, sipas kapitujve te preventivit.

Ne krah te cdo grupimi zerash pune, ndodhen nje kollone me shumatoren e diteve te punes qe duhen per te kryer gjithë zerat e punes qe perbejne grupimin. Keto dite jane llogaritur mbeshtetur mbi analizat teknike te manualeve te ndertimit miratuar nga Keshillit te Ministrave dhe analizave, qe jane pjese e dokumentacionit.

Selektimi ne resht , tregon sa kohe do te zgjase kryerja e ketij punimi, ndersa numuri i vendosur ne cdo qelize e tregon se sa punetore do te punojne ne dite per kete kapitull punimesh.

Ne reshtin e fundit "shuma" tregohet se sa punetore do te punojne per cdo dite ne objekt, kjo eshte si shumatore e diteve te punes te gjithë grupimve ne ate dite ose ate jave te caktuar.

Realizimi i fondeve per cdo muaj parashikohet te jete i barabarte.

Grafiku parashikon, dhe keshtu do te veprohet, qe puna do te nis me pergatitjen e rruges per riveshje, me veprat e artit dhe zerat e tjere.

Punimet do te realizohen duke respektuar kerkesat e projektit, te specifikimeve dhe te kushteve teknike te zbatimit, duke mbajtur dhe dokumentacionin teknik qe kerkon ligji Shqiptar.

Mardhenjet me supervizorin do te mbahen nepermjet dretuesit teknik te objektit ndersa mardhenjet me investitorin do te mbahen vetem nepermjet drejtuesit ligjor dhe teknik te firmes sipas rastit dhe problemit.

STUDIO PROJEKTUESE

IRGEN-SGT GROUP

